



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-141386/26 më 14 SEP 2026

Në bazë të neneve 13 dhe 26 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Locale, të nenit 20 të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, dhe të neneve 52 e 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.Nr.110-391 të datës 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET vendimi për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të Auditimit për Komunën e Prishtinës.

II. Komitetin e Auditimit të Brendshëm nga pika 1 e këtij Vendimi e përbëjnë:

1. Rita Hajzeraj - Ukaj – Kryesuese
2. Visar Perjuci – Anëtar
3. Islam Hasani – Anëtar

III. Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm do të jetë sekretar i komitetit të cekur në pikën I të vendimit, në cilësinë e përcjellësit të takimit të Komitetit.

IV. Mandati i anëtarëve të Komitetit të Auditimit të cekur në pikën II të këtij vendimi është tre (3) vjeçar, me të drejtë riemërimi për edhe një mandat tre (3) vjeçar.

V. Detyrë e komitetit të cekur në pikën I të këtij Vendimi është: ofrimi i këshillave menaxhmentit për KBFP, të sigurojë që menaxhmenti i SSP-së realizon veprimtarinë në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet ligjore, të rishikojë dhe aprovojë planet vjetore të NJAB, të rishikojë raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, deklaratat financiare, përgjigjen e menaxhmentit ndaj çështjeve të ndriçuara nga auditimi i jashtëm, të mbrojnë pavarësinë funksionale të NJAB dhe detyra të tjera të parapara nga pikat 1.9 deri te pika 1.14 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik.

VI. Komiteti i Auditimit të përgatitë raportin vjetor për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik. Raporti duhet të përfshijë pjesët e parapara nga pika 1.1 deri te pika 1.7 të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit.



VIII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të Komitetit;
- Drejtorit të NJAB; dhe
- Qendrës për Shërbime me Qytetarë.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Përparim Rama'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'E KOSOVËS' at the top, 'KRYETARI I KRYEQYTETIT' in the middle, and 'PRISTINA' and 'A KOSOVA' at the bottom. There is also a small emblem in the center of the stamp.